VENDIM
Nr. 739, datë 20.11.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 246, DATË 24.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2019", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 246, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Në ndarjen I, "Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm", të lidhjes nr. 1 që përmendet në pikën 3, bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

a) emërtesa e përmendur në pikën 6 zëvendësohet me emërtesën "drejtor i Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim – kategoria II-b";

b) emërtesa e përmendur në pikën 7 zëvendësohet me emërtesën "drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Diasporës – kategoria II-b";

c) emërtesa e përmendur në pikën 14 zëvendësohet me emërtesën "drejtor i Drejtorisë së Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë – kategoria II-b".

2. Në ndarjen II, "Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm", të lidhjes nr. 1 që përmendet në pikën 3, bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

a) Emërtesat e përmendura në pikat 1, 2, 4, 9, 12, 13 dhe 18 zëvendësohen me emërtesat, si më poshtë vijojnë:

"1. Kapiten i Kapitenarisë së Portit Sarandë, në Kapitenaritë e Porteve dhe Kontrollin Shtetëror Portual, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare - kategoria III- a/1;

2. Përgjegjës i sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë Juridike dhe të Shërbimeve të Mbështetëse, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

4. Shef i sektorit të serverave dhe aplikacioneve për servera, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit - kategoria III-a/1;

9. Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër - kategoria III-a;

12. Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Lezhë - kategoria III-a;

13. Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave - kategoria III-a;

18. Përgjegjës i Sektorit të Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD, për masën 1, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe